

K O N T R A T E

PER THEMELIMIN E SHOQERISE "TELE SPORT" sh.p.k.

E lidhur ndermjet paleve :

1. Muhamet Malo i biri I Seferit i, datelindjes 1957, banuese ne Tirane Rr " Lek Dukagjini" Pall 11.
2. Lirim Zalla I biri I Ademit i, dtl. 1963, banuese ne Tirane Rr " Reshit Collaku" Pall Bara shk 2 Ap 3.

Palet e mesiperme duke qene te pranishem, te deklaruar ortake rane dakord qe kontraten e themelimit te shoqerise se perbashket ta formulojne sipas kerkesave te ligjit nr. 7638 date 19.02.1992 "Mbi shoqerite tregtare", dhe vendosen sa me poshte :


NENI 1

Te krijojne shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar (sh.p.k.) e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, dispozitat e kesaj kontrate, me statutin e perbashket dhe ligjin 7638 dt. 19.02.1992 "Per shoqerite tregtare".

Kjo shoqeri do te emertohet "**TELE SPORT' sh.p.k.**

NENI 2

Shoqeria "**TELE SPORT**" sh.p.k. do te kete Seline e saj ne Tirane ne rrugen "Lek Dukagjini" Pall11 dhe do te ushtroje veprimtari per nje periudhe kohe mbi 15 vjet me te drejte perseritje per periudhen e metejshe, n.q.s. bien dakord ortaket unanimisht, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi.



NENI 3

Shoqeria do te kete per objekt te veprimtarise se saj:
Transmetime radiotelevizive-media,lokale.

NENI 4

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, vendqendrimin e veprimtarise se saj sipas vendimeve qe do te marrin me miratim te Asamblese se ortakeve.

NENI 5

Per realizimin e objektivave te shoqerise ortaket rane dakord te bashkojne kapitalet e tyre, per persosjen e organizimit e zhvillimin e veprimtarise se saj. Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 100.000 Leke te reja, dhe te ndara si me poshte :

1. Muhamet Malo 80% ose 80.000 (tetedhjet mije) leke.
2. Lirim Zalla 20 % ose 20.000 (njetete mije) leke.


Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane nenshkruar e shlyer krejtesisht, pastaj jane ndare ndermjet ortakeve si me siper.

Cdo kuote i takon e drejta e nje vote.

NENI 6

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe do te marrin ortaket, por ne asnje rast njeri ortak nuk mund te detyroje ortakun tjeter te rrise kuoten e tij ne kapitalin e shoqerise.

Ne rast se kapitali i shoqerise per shkak te humbjeve te vertetuara ne dokumentat financiare, rezulton me i vogel se gjysma e kapitalit themeltar, ortaket vendosin brenda tre muajve nga miratimi i llogarive te percaktojne kete humbje mbi mundesine e prishjes se parakoheshme te shoqerise. Ne rast se prishja nuk shpallet, shoqeria zvogelon kapitalin e saj me nje vlere jo me te vogel se ajo e humbjeve qe kane mbetur, pa mbuluar fondet rezerve.



NENI 7

Ortaku qe ka ndermend tu shese te treteve kuota te kapitalit te tij, teresisht apo pjesisht, duhet te njoftoje me pare ortakun tjeter te shoqerise, i cili ka te drejten e parablerjes qofte dhe ne kushte te barabarta ne perputhje me dispozitat e statutit te shoqerise.

NENI 8

Organet drejtuese te shoqerise jane:

- Asambleja e ortakeve
- Administratori

Procedura per emerimin ne funksionet perkatese dhe shkarkimin e tyre rregullohen sipas statutit te shoqerise.

NENI 9

Asambleja drejtohet nga administratori i shoqerise. Ortaket themelues te Shoqerise kane zgjedhur si administrator te saj z. Muhamet Malo.

NENI 10

Vendimet e asamblese jane te vlefshme ne se jane miratuar nga ortakët e saj me vlere me te madhe se 75% te kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblese mund te merren edhe nepermjet konsultimit me shkrim, nese nje nga ortakët nuk ka kerkuar mbledhjen e asamblese.



NENI 11

Likuiditet dhe transaksionet financiare do te depozitohen ne

bankat shqiptare , ku shoqeria ka llogarite e saj rrjedhese.

Per kapitalin themeltar te shoqerise eshte hapur libri i llogarive ku do te shenohet kontributi i secilit ortak. Po keshtu shoqeria ka dhe perdor dokumentacionin sipas kerkesave te ligjit per kontabilitetin e gjithë kerkesave te tjera financiare, te domosdoshme per veprimtarine normale te saj.

NENI 12

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria do te ndahet ndermjet ortakeve ne perpjestim me kontributin e secilit ne kapitalin themeltar te shoqerise, mbasi te jene likuiduar te gjitha detyrimet, dhe te jete hequr 5% qe do te futet ne fondin e rezerves ligjore deri ne permbushjen e 1/10 te kapitalit te shoqerise.

NENI 13

Shoqeria fillon veprimtarine e saj vetem pasi te kete marre autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit ne fuqi.

NENI 14

Ortaket jane te detyruar te ruajne karakterin sekret te dokumentacionit, te eksperiences te shkembyer te realizuar brenda veprimtarise te shoqerise.

NENI 15

Te gjitha mosmareveshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim do te paraqiten per zgjidhje ne gjykatën kompetente shqiptare ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.



NENI 16

Ne rast zgjidhje te kontrates, Asambleja percakton menyren e likuidimit dhe emeron nje ose me shume likuidator sipas normave ligjore.

NENI 17

Kjo kontrate u perpilua ne prani te dy ortakeve duke shprehur ne te vullnetin e lire te tyre.

Kontrata u perpilua ne kater kopje, ne gjuhen Shqipe.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE "TELE SPORT"

Lirim Zalla

Muhamet Malo

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE**

Nr 508. rep
Nr ~~44~~ kol 60



VERTETIM

Sot ne Tirane ne daten 07 FEB 2001 (dymije), para meje Noterit publik, E. Hoxha, me seli ne Tirane, u paraqiten personalisht: Muhamet Malo me pasaporten Nr ~~17-68-744~~ me shtetesi dhe Kombesi Shqiptare.

Lirim Zalla me pasaporte Nr 064 P082.

Te identifikuar prej meje nga dekumentet e identitetit te sipercituara, qe te dy madhore me zotesi te plote per te vepruar qe deklaruar se sa siper gjendet me vullnetin e tyre te lire dhe te plote nenshkruan perpara meje dhe une Noteri I vertetoj ne baze te ligjit.

NOTERI



S T A T U T

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

" TELE SPORT" shpk

Ndermjet:

1. MUHAMET MALO I biri I seferti I dat 1957 banues ne Tirane Rr "Leke Dukagjini " Pall 11.
2. Lirim Zalla I biri I Ademit I dat 1963 banues ne Tirane Rr "reshit Collaku" Pall Bora shkalla 2 ap 3 .

KAPITULLI I

NENE TE PERGJITHESHME


NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar eshte emeruar
" TELE SPORT" shpk qe ketu e ne vazhdim do te quhet
"Shoqeria"

Shoqeria do te jete person juridik Shqipetar sipas nenit 6
te ligjit " Mbi shoqerite tregetare". Shoqeria do te gezoje te
gjithe te drejtat si person juridik dhe do te filloje veprimtarise e
saj nga data e regjistrimit te organet kopetente.

NENI 2

Shoqeria eshte krijuar dhe do te ushtroje aktivitetin e saj
ne baze te legjislacionit Shqipetar perkates ekzistues apo ne
perputhje ne statutin dhe kontraten per themelimin e
shoqerise ashtu edhe dokumentet e tjera te rena dakort nga
palet.



NENI 3

Shoqeria do te kete Seline e saj ne qytetin e Tiranes ne adresen rruga " Leke Dukagjini " Pall 11. Shoqeria do te kete te drejte te lidhe kontrata, te perfitoje te drejta pasurore dhe te drejta personale jo pasurore, te mare persiper detyrime , te veproje si padites ose I paditur ne Gjykate.

Shoqeria do te kete vulen e saj modeli I se ciles miratohet nga mbledhja e Asamblese se ortakeve.

NENI 4

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete mbi 15 vjet nga data fillimit dhe mund te zgjatet me vendim te asamblese se ortakeve . Shoqeria mund te shperbehet perpara ketij afati nga Mbledhja e asamblese se ortakeve sic eshte percaktuar ne statut.

NENI 5

Objekti I veprimtarise se shoqerise do te jete:Trasmetime radiotelevizive-media,lokale.


KAPITULI II

TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE

NENI 6

Cdo ortak ka te drejtat kryesore te meposhteme:

- Shoqeria do te administrohet ne perputhje me Kontraten dhe Statuin e shoqerise dhe me ligjin " Mbi Shoqerite tregetare"
- Ortaket do te marin pjese ne fitimet e shoqerisene cdo forme e vlere ne perputhje me investimin e tyre ne kapitalin e shoqerise.



-Mbajtja e sakte e kontabilitetit dhe procedurave te mbajtjes ne rregull te regjistrimeve do te vendosen , mbahen dhe ndiqen nga Shoqeria te cilat do te pasqyrojne situaten e vertete ekonomike e financiare, ne perputhje me ligjin. Ortakeve do tu lejohet venia ne dispozicion ne cdo kohe te regjistrimeve dhe te te dhenave si dhe te gjithë dokumete te tjera te rendesishme , regjistrimet dhe llogarite kontabile te shoqerise sipas procedurave qe rjedhin nga neni 56 I ligjit “ Mbi shoqerise Tregetare”.

-Kontabiliteti do te mbahet ne lek. Cdo kembim I valutes se huaj ne lek dhe anasjelltas do te realizohet sipas nje kursi zyrtar te nje banke ne Shqiperi ne daten e kryerjes se veprimit,.levizja e burimeve ne valute do te reflektohet ne rregjistrimin e opertecioneve.

-Cdo ortak mund te terhiqet nga shoqeria nese veprimi eshte ne perputhje me nenin 8 te ketij statuti.

NENI 7

Cdo ortak do te kete keto detyrime kryesore.

-te siguroje te dhenat e nevojeshme brenda kontrollit te vecante per shoqerine per zhvillimin e planeve te punes dhe per mbarevajtjen e operacioneve te shoqerise.

-te kryeje detyrat e tjera te caktuara nga statuti per realizimin e qellimit dhe objektivave te shoqerise.

NENI 8

Ne perputhje me nenin 49 te ligjit “ Mbi shoqerite tregetare” pjeset e kapitalit themeltar jane lehtesisht te transferushme ndermjet ortakeve.

Ne perputhje me nenin 47 te ligjit “ Mbi shoqerite tregetare” pjeset e kapitalit themeltar mund ti kalojne personave te trete jashte shoqerise, pasi eshte aprovuar me shumice votash nga ortakët qe prerfaqesojne te pakten tre te katertat e kapitalit themeltar. Ortaket kane te drejten e parablerjes se pjeseve te kapitalit themeltar, ndaj njeri tjetrit.



Te gjithë ortakët duhet të informohen për planin e transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar.

Nëse shoqëria nuk njofton vendimin e saj brenda dy muajve nga data e marrjes së informacionit, transferimi quhet i aprovuar, nëse shoqëria refuzon aprovimin e transferimit, brenda dy muajve nga ky refuzim ortakët duhet ta blejnë vetë ose t'u lejojnë paleve të treta të blejnë pjesën e kapitalit themeltar sipas rregullave të përcaktuara në nenin 11 të ligjit "Mbi shoqëritë tregëtare".

NENI 9

Veprimaria e shoqërisë do të bazohet në të ardhurat ekonomike (nxjerrja e fitimeve) të ortakëve, dhe reflektohet në deklaratat e humbjeve dhe fitimeve (bilanceve).

Shoqëria do të administrojë vetë pasuritë e veta dhe do të ketë të drejtën e përdorimit dhe posedimit të këtyre pasurive në përputhje me qëllimet dhe objektivat e shoqërisë.

KAPITULLI III

KUSHTET EKONOMIKE

NENI 10

Kapitali themeltar do të vendoset në shoqëri nëpërmjet kontributeve të ortakëve. Vlera e kapitalit themeltar është 100.000 (njëqindmijë) lekë të derdhura pranë bankës, dhe e ndare si vijon:

1Muhamet Malo 80% ose 80.000 (të tetëdhjetë mijë) lekë

2Lirim Zalla 20% ose 20.000 (njëzetë mijë) lekë.



Kapitali Themeltar do te ndahet ne pjese me vlere jo me te vogel se 1000 leke secila, cdo pjese jep te drejten e nje vote ne mbledhjen e ortakeve per cdo 1000 lek. Kapitali themeltar mund te ritet nje ose disa here edhe nepermjet kontributeve ne natyre. Ne rast se kapitali I shoqerise e tejkalon ate qe nevojitet per realizimin e objektivave te shoqerise ai mund te reduktohet me vendim te asamblese se ortakeve sipas nenit 64 te ligjit "Mbi Shoqerite Tregetare". Kapitali themeltar dhe mund te shtohet dhe me kontributet shtese te paleve sipas neneve 62 dhe 63 te ligjit " Mbi shoqerite tregetare".


Kapitali I shoqerise I kontribuar nga cdo ortak do te regjistrohet ne librin e regjistrimit te kapitalit te shoqerise.

NENI 11

Viti financiar I shoqerise do te mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti. Ne fund te vitit financiar administratori nepermjet ekserteve kontabel te autorizuar nga Asambleja e ortakeve do te pergatise Bilancin vjetor dhe llogarine e humbjeve dhe fitimeve te shoqerise. Raporti vjetor financiar I paraqitet ortakeve per aprovim para 31 marsit te vitit pasardhes. Raportet tre mujore financiare do ti paraqiten Mbledhjes se ortakeve brenda 30 ditesh nga mbyllja e tre mujorit.

NENI 12

Shoqeria cakton nga fitimet e saj nje fond rezerve. Caktimi I fondit rezerve behet ne masen 5 % te fitimeve sipas nenit 213 te ligjit "Mbi shoqerite tregetare". Pervec fondit rezerve shoqeria mund te krijoje dhe fonde te tjera per realizimin e objektivave te saj me miratim te Asamblese se ortakeve. Shoqeria paguan taksat dhe detyrimet e tjera ligjore perpara shtetit Shqipetar. Humbjet ose fitimet e bartura nga viti I kaluar zbriten ose shtohen respektivisht. Mbas aprovimit te llogarive vjetore dhe verifikimit te shumes se parave qe do te shperndahet, Asambleja e ortakeve vendos pjeset qe do ti shperndahen ortakeve. Shoqeria mund te mare hua ose kredi ne lek ose ne valute te huaj . Kushtet specifike per menyren e



marjes se kredise ose huase sigurimi I garancise etj do te jene kompetence e Asanmblese se ortakeve.

KAPITULI IV

ADMINISTRIMI

NENI 13

Organi vendimarrës I shoqërisë do të jetë asamblëja e ortakëve. Ajo përbehet nga ortakët me të drejtë vote në përpjestim me kontributet e tyre në kapitalin themeltar.

NENI 14


Mbledhja e Asamblëse se ortakëve do të thirret si rregull nga administratori I shoqërisë nëpërmjet një njoftimi me shkrim jo më pak se 15 ditë para datës së mbledhjes. Njoftimi do të përfshijë rendin e ditës vendin, datën dhe kohën e mbledhjes. Një ose më shumë ortakë që përfaqësojnë mbi 10% të pjesëve të kapitalit themeltar mund të kërkojnë mbajtjen e një mbledhje të Asamblëse se ortakëve. Në qoftëse ortakët nuk thirren sipas procedurës së përshkruar më sipër mbledhja është e vlefshme nëse janë të pranishëm të gjithë ortakët. Mbledhja e ortakëve do të mbidhet të paktën dy herë në vit.

NENI 15

Cdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhje por ai mund të përfaqësohet nëpërmjet një prokure të posaçme nga një person tjetër për të cilin nuk është e nevojshme të jetë ortak në shoqëri

NENI 16

Mbledhja E asamblëse se ortakëve I mer vendimet e saj në përputhje me ligjin " Mbi shoqëritë tregëtare" me statutin e



shoqerise dhe kontraten e themelimit. Procesverbali i mbledhjes duhet te firmoset nga ortakët e shoqerise.


NENI 17

Mbledhja e asamblese se ortakëve ka keto kompetenca:

- a. Percakton objektin e veprimtarise se shoqerise dhe mund ta ndryshoje ate.
 - b. Miraton politiken e zhvillimit te shoqerise.
 - c. Miraton eksertet kontabel dhe bilancin e shoqerise
 - d. Percakton masen e shperblimit ndermjet ortakëve te shoqerise.
 - e. Te emeroje likujdatorët e shoqerise.
 - f. Te aprovoje shtesa te neneve te statutit ose kontrates, duke perfshire nje ritje te kapitalit themeltar ose zvogelim te tij, ndryshime lidhur me qelimin e veprimtarise se shoqerise.
 - g. Te mare vendime per kredi afatmesem ose afatgjate.
 - h. Percakton procedurat e mbulimit te humbjeve.
 - i. Miraton rregulloret te procedurave te brendeshme te punes.
- Duke percaktuar numerin e nepunesve ne shoqeri.

NENI 18

Organi drejtues I shoqerise eshte administratori se kompanise e te cilit percaktohet nga Mbledhja e Asamblese se ortakëve. Adminsterator I shoqerise do te jete z. *Muhamet* te drejte I qili zgjidhet per nje periudhe tre vjecare me te drejte tizgjedhje nga Asambleja e ortakëve.



NENI 19

Administratori do te kete autoritet te pergjitheshem ne aktivitetin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise dhe ka te drejten e marjes se cdo ndermarje dhe cdo veprimi qe konsiderohet I nevojeshem per realizimin e qellimit te

shoqerise me perjashtim te resteve qe ligji "Mbi shoqerite tregetare" dhe neni 17 I statutit ia rezervon asamblese se ortakeve. Administratori ka te drejte te propozoje mbljedhjes se asamblese se ortakeve planin e mbledhjeve duke mare vendime per zvillimin e veprimtarive te shoqerise, duke percaktuar dhe linjat kryesore te veprimtarise se shoqerise. Veprimtaria e shoqerise do te drejtohet nga administratori.

ENI 20

Administratori ka keto kopetenca:

- a. te drejtoje veprimtarise e perditeshme te shoqerise.
- b. Te mbykqyre zbatimin e planeve te shoqerise dhe te raportoje per to ne asamblene e ortakeve.
- c. Te administroje pasurite e shoqerise duke perfshire dhe mjetet financiare.
- d. Te perfaqesoje shoqerine me te tretet ne Gjykate dhe arbitrazh, te firmose kontrata ne emer e per llogari te shoqerise me miratimin e mbledhjes se ortakeve.
- e. Te raportoje dhe te pergjigjet para asamblese se ortakeve per veprimtarine e shoqerise.
- f. Ti propozoje asamblese se ortakeve shitesa ne statut duke perfshire nje ritje ose zvogelim te kapitalit themeltar.
- g. Marjen e vendimeve per te gjitha ceshtjet e tjera qe lidhen me drejtimin e shoqerise brenda kopetencave te caktuara nga asambleja e ortakeve.

Shoqeria nuk eshte pergjegjese per pasojat kundrejt te treteve kur mund te provoje se pala e trete ishte ne dieni se Administratori kishte tejkalluar qellimet e shoqerise ose kur palet e trete nuk mund te mos ishin ne dieni te ketyre veprimeve ne rrethana te caktuara.

KAPITULLI V

PUSHIMI I SHOQERISE



NENI 21

Veprimatiria e shoqerise do te pushoje branda afatit te kohezgtjatjes se veprimatarise se shoqerise

NENI 22

Shoqeria likujdohet sipas procedurave te meposhteme ne perputhje me nenet 264 e vijues te ligjit " Mbi shoqerite tregetare"


Asambleja e ortakeve do te emeroje komisionin e likujdimit I cili do te dorezoje per aprovim bilancin perfundimtar te likujdimit dhe dokumentet e lidhura me te sipas neni 270 te ligjit " Mbi shoqerite tergetare" asamblese se ortakeve dhe shoqeria pushon veprimtarine e saj si dhe mbyllja e shoqerise do te regjistrohete ne regjistrin tregetar.

Nese mbledhja e ortakeve vendos unanimisht qe mjetet e sjella nga njeri prej ortakeve do ti kthehen atij duke e kredituar per vleren dhe koston e kthimit ne vendin e ortakut.

Ne qoftese asambleja e ortakeve vendos unanimisht te paguaje borxhet nese ka, qe rezultojne nga bilanci perfundimtar, do te perpiqet tia shese mjetet dhe pasurite nje personi te trete me cmime dhe kushte te favorshme duke mare parasysh dhe amortizimin fiktiv.

NENI 23

Per konfliktet qe mud te lindin brenda shoqerise organi kopotent do te jete Gjykata e shkalles se pare Tirane.




ENI 24

Ceshtjet pa mbuluara nga ky statut do te regullohen nga legjislacioni Shqipetar dhe ne vecanti nga ligji "Mbi shoqerite tregetare".

ORTAKET E SHOQERISE

Muhamet Malo



Lirim Zalla



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr 501... rep

Nr.61.....kol

VERTETIM


Sot ne Tirane ne daten 07 FEB 2001, para meje Noterit publik, E. Hoxha, me seli ne Tirane Bulevardi prane gjykates se Tiranes, u paraqiten personalisht:

Muhamet Malo me pasaporte Nr 1768844

Lirim Zalla me pasaporte Nr 064 9082

qe te dy madhore me zotesi te plote per te vepruar qe deklaruar se sa siper gjendet me vullnetin e tyre te lire dhe te plote nenshkruan perpara meje dhe une Noteri I vertetoj ne baze te ligjit

NOTERI



by M. Bedi,
18.02.2001
08 FEB. 2001


TIRANE ME 07.02.2001

KERKESE
PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

KERKUESI Muhamet Malo I biri I Seferit I dat 1957 lindur dhe banues ne Tirane Rr "Leke Dukagjini" Pall 11.

KERKOHET Regjistrimi si person juridik I Shoq "TELE SPORT" SH.P.K.

BAZA LIGJORE ligji 7638 date 19.02.1992 mbi shoq tregtare.



ARE

be regjistruar
dt 12-02-2001
M. Bedi
P. Bedi

Z. kryetar I seances.

Ne baze te kontrates date 07.02.2001 eshte themeluar shoqeria me pergjesi te kufizuar me emertimin "**TELE SPORT**" sh.p.k. e cila ka si ortake te saje mua kerkuesin dhe Lirim Zallen me nje kapital themeltare prej 100 000 lek te reja dhe I ndare une kerkuesi 80%, dhe Lirim Zalla 20%.

Selia e shoqerise do te jete ne Tirane ne Rr " Leke Dukagjini "palla 11.

Administratori I shoqerise do te jem une kerkuesi Muhamet Malo.

Objekti I veprimtarise se shoqerise do te jete:Trasmetimi radiotelevizive-media.



[Handwritten signature]